***Republika e Kosovës***
***Republika Kosova-Republic of Kosovo***
***Qeveria –Vlada-Government***

***Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/***
***Ministarstvo Obrazovanja i Nauke, Tehnologije i Inovacija / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation***

---

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (MASHTI) NR. 11/2023 PËR KURRIKULËN ME ZGJEDHJE NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR**

**ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (MESTI) NO. 11/2023 FOR THE ELECTIVE CURRICULUM IN PRE-UNIVERSITY EDUCATION**

**ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO (MONTI) BR. 11/2023 ZA IZBORNI KURIKULUMU U PREDUNIVERZITETSKOM OBRAZOVANJU**

| | | |
|---|---|---|
| Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të nenit 24 paragrafi 6 nënparagrafi 6.1 të Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 17/18 shtator 2011), nenit 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4, shtojca 1 paragrafi 7 i Rregullores (QRK) nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive të datës 30. 03.2021, Udhëzimit administrativ nr. 03/2013 për standardet e hartimit të akteve normative (GZ, nr. 03/2013, dt. 16.05.2013) nxjerr: | Ministry of Education, Science, Technology and Innovation, pursuant to Article 24 paragraph 6 sub-paragraph 6.1 of the Law no. 04 / L-032 on Pre-university education (Official Gazette of the Republic of Kosova no. 17/ 18 September 2011), Article 8, paragraph 1, subparagraph 1.4, Appendix 1, paragraph 7 of the Regulation (GRK) no. 02/2011 on areas of administrative responsibility of the Prime Minister's Office and Ministries (30. 03.2021, Administrative instruction no. 03/2013 on the standards for drafting normative acts (OG, no. 03/2013, dated 16.05. 2013) issue: | Ministarstvo obrazovanja, nauke, tehnologije i inovacije, u skladu sa članom 24 stav 6 tačka 6.1 Zakona br. 04/L-032 o preduniverzitetskom obrazovanju (Službeni glasnik Republike Kosovo br. 17/18 septembar 2011), član 8 stav 1 podstav 1.4, aneks 1 stav 7 Uredbe (VRK) br. 02/2021 za oblasti administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstava od 30. 03,2021, Administrativnog uputstva br. 03/2013 o standardima za izradu normativnih akata (SG, br. 03/2013, dat. 16.05.2013.) izdaje, |
| **UDHËZIM ADMINISTRATIV PËR KURIKULËN ME ZGJEDHJE NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR** | **ADMINISTRATIVE INSTRUCTION FOR THE ELECTIVE CURRICULUM IN PRE-UNIVERSITY EDUCATION** | **ADMINISTRATIVNO UPUTSDTVO O IZBORNOM KURIKULUMU U PREDUNIVERZITETSKOM OBRAZOVANJU** |
| **Neni 1**<br>**Qëllimi** | **Article 1**<br>**The purpose** | **Član 1**<br>**Cilj** |
| Ky Udhëzim administrativ, përcakton dhe rregullon format e realizimit të kurrikulës me zgjedhje dhe procedurat për propozimin, përzgjedhjen dhe aprovimin e kurrikulës me zgjedhje, në pajtim me Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës. | This Administrative Instruction, defines and regulates the forms of implementation of the elective curriculum and the procedures for proposing, selecting and approving the elective curriculum, in accordance with the Curriculum Framework of Pre-University Education of the Republic of Kosova and the Core Curriculum. | Ovo Administrativno uputstvo definiše i reguliše oblike realizacije izbornog kurikuluma i procedure za predlaganje, izbora i usvajanje izbornog kurikuluma, u skladu sa Okvirom kurikuluma preduniverzitetskog obrazovanja Republike Kosovo. |

| | | |
|---|---|---|
| **Neni 2**<br>**Fushëveprimi** | **Article 2**<br>**Scope** | **Član 2**<br>**Oblast delovanja** |
| Ky Udhëzim administrativ, zbatohet nga të gjitha institucionet arsimore parauniversitare publike dhe private, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Kosovës. | This Administrative Instruction is, implemented by all public and private pre-university educational institutions, in accordance with the legal provisions in force in the Republic of Kosova. | Ovo administrativno uputstvo, se primenjuje u svim javnim i privatnim preduniverzitetskim institucijama, u skladu sa važećim zakonskim odredbama u Republici Kosovo. |
| **Neni 3**<br>**Përkufizimet** | **Article 3**<br>**Definitions** | **Član 3**<br>**Definicije** |
| 1. Për qëllime të këtij Udhëzimi administrativ, shprehjet e mëposhtme, kanë këtë kuptim: | 1. For the purposes of this Administrative Instruction, the following expressions have this meaning: | 1. Za potrebe ovog Administrativnog uputstva, izrazi u nastavku imaju sledeći značaj: |
| 1.1. **“Kurrikula bërthamë”** – nënkupton dokumentin themelor kurrikular për arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, dispozitat e së cilës vendosen nga MASHTI dhe janë obliguese për të gjitha shkollat; | 1.1. **"Core Curriculum"** - means the basic curriculum document for primary, lower secondary and higher secondary education, the provisions of which are set by the MESTI and are mandatory for all schools; | 1.1. **"Osnovni kurikulum"** - podrazumeva osnovni kurikularni dokument za osnovno, niže srednje i više srednje obrazovanje, čije odredbe utvrđuje MONTI i obavezne su za sve; |
| 1.2. **“Shkallët kurrikulare”**- nënkupton nën-nivelet formale të arsimit (një deri tre klasë) të cilat paraqesin pikën referuese për përcaktimin e kompetencave kryesore që duhen zotëruar nga të gjithë nxënësit, kërkesat e progresit të nxënies, organizimin e proceseve mësimore, qasjen dhe kriteret | 1.2. **"Curricular levels"** - means the formal sub-levels of education (one to three grades) which represent the reference point for defining the main competencies to be mastered by all students, requirements for learning progress, organization of learning processes, approach and criteria of | 1.2. **„Kurikularni nivoi“** – podrazumevaju formalne pod-nivoe obrazovanja (jedan do tri razreda) koji predstavljaju referentnu tačku za definisanje glavnih kompetencija koje treba da ovladaju svi učenici, zahtevi progresa u učenju, organizovanju nastavnom procesu, pristup i kriterijume |

| | | |
|---|---|---|
| e vlerësimit. Ato janë njësia kryesore për planifikimin dhe organizimin e procesit mësimor si dhe për vlerësimin e nxënësve; | evaluation. They are the main unit for organizing learning process and for student assessment; | za ocenjivanje. To su glavne jedinice za planiranje i organizovanje nastavnog procesa, kao i za ocenjivanje učenika; |
| 1.3. **“Kurrikula me zgjedhje” -** është pjesë e kurrikulës me bazë në shkollë që zbatohet në kuadër të orarit të obliguar, të përcaktuar me planin mësimor, për adresimin e nevojave dhe kërkesave specifike të nxënësve të shkollës së caktuar si dhe çështjeve me interes për komunitetin në të cilin vepron shkolla; | 1.3. **“Elective curriculum” -** it is part of the school-based curriculum that is implemented within mandatory schedule, determined by the curriculum, for addressing the specific needs and requirements of the students of the given school, as well as issues of interest to the community in which the school operates; | 1.3. **„Izborni kurikulum“** – je deo kurikuluma sa osnovom u školi koji se primenjuje u okviru obaveznog rasporeda, definisanim nastavnim planom i programom, radi rešavanja specifičnih potreba i zahteva učenika određene škole, kao i pitanja od interesa za zajednicu u kojoj škola; |
| 1.4. **“Lënda mësimore (me zgjedhje)”** – nënkupton formën e organizimit didaktik të përmbajtjes mësimore si një disiplinë e veçantë e të nxënit në kuadër të një fushe kurrikulare, për ndërtimin e njohurive të reja dhe kompetencave kryesore nga nxënësit. Organizimi i përmbajtjes së një lënde mësimore mund të jetë në formë të moduleve apo temave, të cilat zbërthehen tutje përmes njësive mësimore; | 1.4. **"Teaching subject (elective)"** - means the form of didactic organization of teaching content as a special discipline of learning within a curricular area, for the construction of new knowledge and key competencies by students. The organization of a teaching subject content can be in the form of modules or topics, which are further broken down through learning units; | 1.4. **„Nastavni predmet (izborni)“** – podrazumeva oblik didaktičkog organizovanje nastavnog sadržaja kao posebne discipline učenja u okviru kurikularne oblasti, za izgradnju novih znanja i ključnih kompetencija učenika. Organizovanje sadržaja određenog nastavnog predmeta može biti u obliku modula ili tema, koje se dalje razlažu kroz nastavne jedinice; |
| 1.5. **“MASHTI”**– nënkupton Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit; | 1.5. **”MESTI”** - Ministry of Education, Science, Technology and Innovation; | 1.5. **„MONTI“** – znači Ministarstvo obrazovanja, nauke, tehnologije i inovacije; |
| 1.6. **“DKA”** - nënkupton Drejtorinë përkatëse Komunale të Arsimit; | 1.6. **“MED”** - means the respective Municipal Education Directorate; | 1.6. **"ODO"** - znači Opštinski direktorijat za obrazovanje; |

| | | |
|---|---|---|
| 1.7. **"KDSH"** – nënkupton Këshillin Drejtues të Shkollës. | 1.7. **"SSC"** - means School Steering Council. | 1.7. **„KDSH"** – znači Školski upravni odbor. |
| **Neni 4**<br>**Forma e realizimit** | **Article 4**<br>**Implementation forms** | **Član 4**<br>**Oblik realizacije** |
| 1. Kurrikula me zgjedhje realizohet në formë të lëndëve të reja, që nuk janë përcaktuar me Kurrikulën bërthamë. Kurrikula me zgjedhje mundëson zhvillimin e kompetencave kryesore, duke adresuar nevojat dhe kërkesat specifike të nxënësve të shkollës përkatëse dhe komunitetit në të cilin vepron shkolla. | 1. The elective curriculum is implemented in the form of new subjects, which are not defined by the Core Curriculum. The elective curriculum enables the development of key competencies, addressing the specific needs and requirements of the students of the respective school and the community in which the school operates. | 1. Izborni kurikulum realizuje se u obliku novih predmeta, koji nisu definisani Osnovnim kurikulumom. Izborni kurikulum omogućava razvoj ključnih kompetencija, rešavajući specifične potrebe i zahteve učenika dotične škole i zajednice u kojoj škola deluje. |
| 2. Gjatë një viti shkollor, për një klasë, mund të realizohet vetëm një lëndë me zgjedhje. | 2. During one school year, for one class, only one elective course can be completed. | 2. U toku jedne školske godine za jedno odeljenje može se realizovati samo jedan izborni predmet. |
| 3. Lënda me zgjedhje, realizohet në kuadër të fondit të orëve mësimore të përcaktuara me planin mësimor për klasën përkatëse. | 3. The elective subject is implemented within the fund of teaching hours defined by the curriculum for the respective class. | 3. Izborni predmet, se realizuje u okviru fonda nastavnih časova definisanim nastavnim planom za odgovarajući razred. |
| **Neni 5**<br>**Kohëzgjatja** | **Article 5**<br>**Duration** | **Član 5**<br>**Trajanje** |
| 1. Kurrikula me zgjedhje planifikohet për çdo klasë dhe çdo vit shkollor, duke filluar nga klasa e parë e nivelit fillor deri në klasën e 12 të nivelit të mesëm të lartë. | 1. Elective curricula is planned for each grade and each school year, starting from the first grade of the primary level up to the 12th grade of higher secondary level. | 1. Izborni kurikulum se planira za svaki razred i svaku školsku godinu, počev od prvog razreda osnovni nivo pa do 12 razred više srednji nivo. |

| | | |
|---|---|---|
| 2. Lënda me zgjedhje mbulon së paku një vit shkollor.<br><br>**Neni 6**<br>**Propozimi i lëndëve me zgjedhje**<br><br>1. Propozimet për lëndët me zgjedhje, i përgatit shkolla dhe MASHTI, duke pasur parasysh:<br><br>1.1. Veçoritë e shkallës kurrikulare, të përshkruara në Kornizën Kurrikulare dhe Kurrikulën Bërthamë;<br><br>1.2. Ndërlidhjen me rezultatet e të nxënit për kompetenca dhe për fusha kurrikulare;<br><br>1.3. Çështjet me interes të veçantë në nivel nacional, për lëndët e propozuara nga MASHTI dhe në nivel lokal, për lëndët e propozuara nga shkollat.<br><br>2. MASHTI, i përgatit së paku nga tri propozime për çdo klasë, të cilat mund të plotësohen apo rishikohen sipas nevojës:<br><br>2.1. Lëndët e kurrikulës me zgjedhje të propozuara nga MASHTI publikohen në faqen zyrtare të saj; | 2. The elective subject covers at least one school year.<br><br>**Article 6**<br>**Proposal of elective subjects**<br><br>1.Proposals for elective subjects are prepared by the school and MESTI, taking into account:<br><br>1.1. Curriculum level features, described in the Curriculum Framework and Core Curricula.<br><br>1.2. Correlation with learning outcomes for competencies and for curricular areas;<br><br>1.3. Issues of special interest at national level, for subject proposed by MESTI and at local level, for subjects proposed by schools.<br><br>2. MESTI prepares at least three proposals for each class, which can be completed or revised as needed.<br><br>2.1. The elective curriculum subjects proposed by MESTI are published on its official website. | 2. Izborni predmet pokriva najmanje jednu školsku godinu.<br><br>**Član 6**<br>**Predlaganje izbornih predmeta**<br><br>1. Predloge za izborne predmete, pripremaju škole i MONTI, uzimajući u obzir:<br><br>1.1. Karakteristike kurikularnog nivoa, opisane u Okvir kurikuluma i Osnovni kurikulum;.<br><br>1.2. Korelacija sa rezultatima učenja za kompetencije i kurikularne oblasti;<br><br>1.3. Pitanja od posebnog interesa na nacionalni nivo, za predmete predložene od strane MONTI-a i na lokalnom nivou, za predmete predložene od strane škola.<br><br>2. MONTI priprema najmanje po tri predloga za svaki razred, koji se mogu prema potrebi popuniti ili revidirati.<br><br>2.1. Predmet izbornog kurikuluma koje predlaže MONTI objavljeni su na njegovom zvaničnom sajtu. |

| | | |
|---|---|---|
| 2.2. Për çdo plotësim apo rishikim të propozimeve, MASHTI i informon shkollat përmes DKA-ve dhe i publikon në faqen zyrtare të MASHTI-it.<br><br>3. Shkolla mund të përzgjedhë nga lista e propozuar e MASHTI-t, të përgatisë propozime të tjera apo t`i kombinojë të dyja;<br><br>3.1. Listat e propozimeve për lëndët me zgjedhje përgatiten nga këshillat e klasave, duke pasur parasysh nevojat e nxënësve, nga perspektiva e kritereve të përshkruara në paragrafin 1 të këtij neni dhe nga mundësitë e shkollës për organizim cilësor të kurrikulës me zgjedhje;<br><br>3.2. Lista e lëndëve me zgjedhje përmban së paku 3 propozime, për çdo klasë.<br>3.3. Secili propozim përmban:<br>3.3.1. Emërtimin e lëndës së propozuar;<br>3.3.2.Arsyeshmërinë për propozimin e saj;<br>3.3.3. Qëllimin e lëndës së propozuar;<br>3.3.4. Konceptet kryesore të lëndës së propozuar. | 2.2. For any completion or revision of the proposals, MESTI informs the schools through the MEDs and publishes them on MESTI's official website.<br><br>3. The school can select from the proposed list of MESTI, to prepare other proposals or combine both;<br><br>3.1. Lists of proposals for elective courses are prepared by the class councils, taking into account the needs of the students, from the perspective of the criteria described in paragraph 1 of this article and from the school's possibilities for quality organization of the elective curriculum;<br><br>3.2. List of elective subjects should contain at least 3 proposals, for each class;<br>3.3. Each proposal contains:<br>3.3.1. Naming the proposed subject;<br>3.3.2. Reasonableness of its proposal;<br>3.3.3. Purpose of proposed subject;<br>3.3.4. Main concepts of the proposed subject. | 2.2. Za svaku dopunu ili reviziju predloga, MONTI obaveštava škole preko ODO-a i objavljuje ih na zvaničnom sajtu MONTI-a.<br><br>3. Škola može da izabere sa liste koje predloži MONTI-a da pripremi druge predloge ili da kombinuje obadve;<br><br>3.1. Liste predloga izbornih predmeta priprema saveti odeljenja, vodeći računa o potrebama učenika, iz ugla kriterijuma iz stava 1. ovog člana i iz mogućnosti škole za kvalitetno organizovanje izbornog programa;<br><br>3.2. Lista izbornih predmeta sadrži najmanje 3 predloga, za svaki razred.<br><br>3.3. Svaki predlog sadrži:<br>3.3.1. Naziv predloženog predmeta;<br>3.3.2. Obrazloženje za svoj predlog;<br>3.3.3. Svrha predloženog predmeta;<br>3.3.4. Glavni koncepti predloženog predmeta. |

| | | |
|---|---|---|
| 4. Këshillat e klasave i dorëzojnë listat e propozimeve te drejtori i shkollës. | 4. The class councils submit the lists of proposals to the school principal. | 4. Saveti odeljenja dostavljaju liste predloga direktoru škole. |
| 5. Drejtori i shkollës emëron Komisionin ad-hoc për administrimin e procedurës së përzgjedhjes së lëndëve me zgjedhje: | 5. The school principal appoints the ad-hoc Committee for the administration of the elective course selection procedure. | 5. Direktor škole imenuje ad hoc komisiju za administriranje postupka izbora izbornog predmeta. |
| 5.1. Vendimi për emërimin e Komisionit përcakton listën e anëtarëve, kryesuesin, mënyrën e funksionimit, detyrat dhe afatet për realizimin e tyre; | 5.1. The decision on the appointment of the Commission determines the list of members, the chairperson, the operation mode, the tasks and the deadlines for their realization. | 5.1. Odluka o imenovanju Komisije utvrđuje spisak članova, predsedavajućeg, način rada, zadaci i rokovi za njihovu realizaciju. |
| 5.2. Kryesues i Komisionit mund të caktohet njëri anëtar i komisionit nga radhët e mësimdhënësve. | 5.2. One of the members of the commission from among the teachers, can be appointed as the Chairman of the Commission. | 5.2. Predsedavajući komisije može biti imenovan jedan od članova komisije iz redove nastavnika |
| **Neni 7**<br>**Përbërja dhe detyrat e Komisionit për kurrikulën me zgjedhje** | **Article 7**<br>**The composition and duties of the commission for elective curriculum** | **Član 7**<br>**Sastav i dužnosti Komisije za izborni kurikulum** |
| 1. Komisioni për kurrikulën me zgjedhje përbëhet nga: | 1. The commission for elective curriculum is composed from: | 1. Izbornu komisiju za izborni kurikulum sastoji se od : |
| 1.1.Tre mësimdhënës, të cilët nuk janë kandidatë potencial për realizimin e kurrikulës me zgjedhje; | 1.1. Three teachers, who are not potential candidates for the implementation of the elective curriculum; | 1.1.Tri nastavnika, koji nisu potencijalni kandidati za realizaciju izbornog kurikuluma; |
| 1.2. Një përfaqësues i Këshillit të Prindërve; | 1.2. O ne representative of the Parent Council; | 1.2. Jedna predstavnik Saveta roditelja; |

| | | |
|---|---|---|
| 1.3. Një përfaqësues i Këshillit të Nxënësve. | 1.3. O ne representative of the Students Council; | 1.3. Jedna predstavnik Saveta učenika. |
| 2. Komisioni për kurrikulën me zgjedhje është përgjegjës për: | 2. The commission for elective curriculum is responsible for: | 2. Komisiju za izborni kurikulum je odgovoran za: |
| 2.1. Shqyrtimin e propozimeve të Këshillave të Klasës për kurrikulën me zgjedhje; | 2.1. Reviewing the proposals of the Class Councils for the elective curriculum. | 2.1. Razmatranje predloga Saveta odeljenja za izborni kurikulum. |
| 2.2. Përgatitjen e formularëve të deklarimit të nxënësve dhe prindërve për kurrikulën me zgjedhje; | 2.2. Preparation of student and parent declaration forms for the elective curriculum. | 2.2. Priprema obrazaca izjava učenika i roditelja za izborni kurikulum. |
| 2.3. Menaxhimin e procesit të deklarimit dhe përzgjedhjes së kurrikulës me zgjedhje për çdo klasë; | 2.3. The process management of declaring and selecting the elective curriculum for each class. | 2.3. Upravljanje procesom izjašnjavanje i izbora izbornog kurikuluma za svaki razred. |
| 2.4. Respektimin e afateve të përcaktuara me këtë UA, për organizimin e kurrikulës me zgjedhje; | 2.4. Respecting the deadlines set by this AI for the organization of the elective curriculum. | 2.4. Poštovanje rokova utvrđenih ovim UA za organizovanje izbornog kurikuluma. |
| 2.5. Përgatitjen e dosjes për procesin e organizimit të kurrikulës me zgjedhje; | 2.5. The file preparation for the process of organizing the elective curriculum. | 2.5. Priprema dosijea za proces organizovanja izbornog kurikuluma. |
| 2.6. Detyra të tjera të lidhura me organizimin e kurrikulës me zgjedhje, të përcaktuara nga drejtori i shkollës me aktin e emërimit të komisionit. | 2.6. Other tasks related to the organization of the elective curriculum, determined by the school principal with the act of appointment of the commission. | 2.6. Ostale dužnosti u vezi sa organizovanjem izbornog kurikuluma, koje utvrđuje direktor škole aktom o imenovanju komisije. |
| 3. Detyrat ndërmjet anëtarëve të Komisionit ndahen me marrëveshje. | 3. The tasks between the members of the Commission are divided by agreement. | 3. Dužnosti između članova Komisije dele se sporazumom. |

| | | |
|---|---|---|
| 4. Raporti i punës së Komisionit i dorëzohet Drejtorit të shkollës.<br><br>**Neni 8**<br>**Deklarimi dhe përzgjedhja**<br><br>1. Procesi i deklarimit dhe përzgjedhjes, për secilën klasë, administrohet nga Komisioni për kurrikulën me zgjedhje.<br><br>2. Formularët e deklarimit përgatiten nga Komisioni për kurrikulën me zgjedhje.<br><br>3. Secili formular i deklarimit (për secilën klasë) përmban emërtimin e lëndëve të propozuara, qëllimin dhe konceptet kryesore për secilën lëndë si dhe hapësirën për emrin e nxënësit i cili bën deklarimin, apo për të cilin bëhet deklarimi.<br><br>4. Për nivelin fillor, duke filluar nga klasa e parë, deklarimi bëhet nga prindërit e nxënësve.<br><br>5. Për nivelin e mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, deklarimi bëhet nga nxënësit.<br><br>6. Prindërit, respektivisht nxënësit, deklarohen për njërën prej lëndëve të propozuara në formularët e deklarimit. | 4. The Commission's work report is submitted to the school principal.<br><br>**Article 8**<br>**Declaration and selection**<br><br>1. The declaration and selection process for each class is administered by the Elective Curriculum Commission.<br><br>2. Declaration forms are prepared by the Elective Curriculum Commission.<br><br>3. Each declaration form (for each class) contains the name of the proposed subjects, purpose, main concepts for each subject, and the space for the student name who makes the declaration, or for whom the declaration is made.<br><br>4. For the primary level, starting from the first grade, the declaration is made by the students' parents.<br><br>5. For lower secondary and higher secondary level, the declaration is made by the students.<br><br>6. Parents, respectively students, declare for one of the proposed subjects in the declaration forms. | 4. Izveštaj o radu Komisije dostavlja se Direktoru škole.<br><br>**Član 8**<br>**Deklaracija i izbor**<br><br>1. Proces deklarisanja i selekcije, za svaki razred administrira Komisija za izborni kuriulum.<br><br>2. Obrasce deklarisanja priprema Komisija za izborni kurikulum.<br><br>3. Svaki obrazac deklarisanja (za svaki razred) sadrži naziv predloženih predmeta, svrhu i glavne koncepte za svaki predmet, kao i prostor za ime učenika koji se izjašnjava, odnosno za koji se vrši deklarisanje.<br><br>4. Pa osnovni nivo počev od prvi razred, izjavu pod zakletvu daje roditelj učenika.<br><br>5. Za niže srednji nivo i više srednji nivo, počev, deklarisanje vrše učenici.<br><br>6. Roditelji, odnosno učenici, se deklarišu za jedan od predloženih predmeta u obrascima deklaracije. |

| | | |
|---|---|---|
| 7. Komisioni përzgjedh lëndën më të kërkuar nga të gjithë prindërit, respektivisht nxënësit e të gjitha paraleleve për secilën klasë.<br><br>**Neni 9**<br>**Hartimi i programit**<br><br>1. Mësimdhënësi i lëndës me zgjedhje përgatit draftprogramin lëndor, të cilin ia dorëzon për shqyrtim aktivit profesional të fushës përkatëse kurrikulare.<br><br>2. Mësimdhënësi e finalizon programin në bashkëpunim me aktivin profesional të fushës kurrikulare përkatëse.<br><br>2.1. Mësimdhënësi i lëndës me zgjedhje i përzgjedhur sipas paragrafi 2.2 dhe 2.3 të Nenit 10 finalizon programin në bashkëpunim me aktivin profesional të fushës kurrikulare përkatëse.<br><br>3. Struktura e programit të lëndëve me zgjedhje është e njëjtë me strukturën e programeve të lëndëve tjera.<br><br>4. Nëse lënda e njëjtë propozohet nga Këshilli i klasës dhe zgjidhet nga nxënësit, respektivisht prindërit, edhe në vitin pasues | 7. The commission selects the most requested subject from all parents, respectively students of all parallels for each grade.<br><br>**Article 9**<br>**Drafting of the program**<br><br>1. The teacher of the elective subject prepares the draft subject program, which submits for review to the professional asset of the relevant curricular field;<br><br>2.The teacher of the elective subject finalizes the program in cooperation with the professional asset of the relevant curricular field;<br><br>2.1.The teacher of the elective subject selected according to paragraph 2.2 and 2.3 of Article 10 finalizes the program in cooperation with the professional asset of the relevant curricular field;<br><br>3.The structure of the elective subject program is the same as the structure of other subject programs;<br><br>4. If the same subject is proposed by the Class Council and is elected by students, respectively parents, even in the following | 7. Komisija bira predmet koji su najtraženiji od strane svih roditelja, odnosno učenika svih odeljenja za svaki razred.<br><br>**Član 9**<br>**Izrada programa**<br><br>1. Nastavnik izbornog predmeta priprema nacrt predmetnog programa, koji dostavlja na razmatranje stručnom aktivu relevantne kurikularne oblasti;<br><br>2. Nastavnik finalizuje program u saradnji sa stručnim aktivom odgovarajuće kurikularne oblasti.<br><br>2.1. Nastavnik izbornog predmeta bira shodno 2.2 i 2.3 Člana 10 finalizuje program u saradnji sa stručnim kativnom relevantne kuikularne oblasti.<br><br>3. Struktura programa izbornog predmeta je ista kao i struktura ostalih predmeta;<br><br>4. Ako isti predmet predloži Razrednom savetu i bude izabran od strane učenika odnosno roditelja, i naredne školske |

| | | |
|---|---|---|
| shkollor, programi i lëndës hartohet edhe për klasën pasuese. | school year, the subject program is designed also for the following grade. | godine, program predmeta se sastavlja i za naredni razred. |
| **Neni 10**<br>**Përzgjedhja dhe angazhimi i kuadrit mësimor** | **Article 10**<br>**Selection and engagement of teaching staff** | **Član 10**<br>**Izbor i angažovanje nastavnog kadra** |
| 1. Kuadri për realizimin e kurrikulës me zgjedhje, duhet të jetë mësimdhënës i kualifikuar. | 1. The staff for the implementation of the elective curriculum must be a qualified teacher. | 1. Okvir za realizaciju izbornog kurikuluma mora biti kvalifikovan nastavnik. |
| 2. Kurrikula me zgjedhje mund të realizohet nga kuadri mësimor i shkollës përkatëse: | 2. The elective curricula can be implemented by the teaching staff of the respective school. | 2. Izborne kurikulum može realizovati nastavno osoblje dotične škole. |
| 2.1. Propozimin e mësimdhënësve për realizimin e lëndëve me zgjedhje e bëjnë këshillat e klasave, pas pranimit të njoftimit nga Komisioni për lëndën e përzgjedhur; | 2.1.The teachers' proposal for the realization of elective subjects is made by the class councils, after receiving the notification from the Commission for the selected subject; | 2.1. Predlog nastavnika za realizaciju izbornog predmeta obavljaju saveti roditelja, nakon dobivanje obaveštenja od strane Komisije za izborne predmete; |
| 2.2. Në rast se për lëndën e njëjtë shkolla ka dy e më tepër mësimdhënës të kualifikuar dhe të interesuar, përzgjedhja bëhet në bazë të cilësisë së programit të hartuar nga mësimdhënësit e propozuar; | 2.2. If the school has two or more qualified and interested teachers for the same subject, the selection is based on the quality of the program designed by the proposed teachers. | 2.2. U slučaju da za isti predmet škola ima dva ili više kvalifikovanih nastavnika i zainteresovanih, izbor se vrši na osnovu kvaliteta programa izrađenog od strane predloženog nastavnika. |
| 2.3. Cilësinë e programit e vlerëson aktivi profesional i fushës kurrikulare përkatëse. | 2.3. The quality of the program is evaluated by the professional asset of the relevant curriculum field. | 2.3. Kvalitet prugama ocenjuje stručni aktiv dotične kurikularne oblasti. |

| | | |
|---|---|---|
| 3. Nëse shkollës i mungon kuadri mësimdhënës për realizimin e kurrikulës me zgjedhje, shkolla bën kërkesë në DKA për kuadër përkatës, bashkë me raportin e përzgjedhjes së lëndës përkatëse:<br><br>3.1. Kërkesa nga shkolla bëhet në rastet kur Këshillat e Klasave konstatojnë se për realizimin e kurrikulës me zgjedhje mungon kuadri adekuat mësimdhënës;<br><br>3.2. Pas miratimit të kërkesës së shkollës, DKA bën thirrje publike për mundësinë e angazhimit të mësimdhënësve;<br><br>3.3. Kandidatet që aplikojnë për kurrikulën me zgjedhje, të cilët i plotësojnë kriteret e kualifikimit, që janë të punësuar apo kanë kontratë në komunën përkatëse, përzgjidhen nga DKA dhe përfshihen në hartimin e programit të kurrikulës me zgjedhje;<br><br>3.4. Përzgjedhja e mësimdhënësit nga DKA bëhet duke u bazuar në cilësinë e programeve të dorëzuara;<br><br>3.5. Angazhimi i tyre nga DKA bëhet njëkohësisht me aprovimin e listës | 3. If the school lacks the teaching staff for the implementation of the elective curriculum, the school applies to the MED for the relevant staff, together with the report on the selection of the relevant subject.<br><br>3.1. The request from the school is made in cases where the Class Councils find that there is a lack of adequate teaching staff for the implementation of the elective curriculum;<br><br>3.2. After approving the school's request, MED makes a public call with the possibility of engaging teachers;<br><br>3.3. Candidates who apply for the elective curriculum, who meet the qualification criteria, who are employed or have a contract in the relevant municipality, are selected by the MED and are included in the design of the elective curriculum program;<br><br>3.4. The selection of teachers by MED is based on the quality of the submitted programs.<br><br>3.5. Their engagement by DKA is done simultaneously with the approval of the final list of elective curriculum subjects. | 3. U koliko školi nedostaje nastavni kadar za realizaciju izbornog kurikuluma, škola podnosi zahtev ODO za relevantan kadar, sa izborni izveštaj dotičnog predmeta.<br><br>3.1. Škola podnosi zahtev vrši u slučaju da Saveti odeljenja konstatuju da za realizaciju izbornog kurikuluma nedostaju adekvatni nastavnici.<br><br>3.2. Nakon usvajanje zahteva škola, ODO vrši javni poziv za mogućnost angažovanje nastavnik;<br><br>3.3. Kandidati koji konkurišu za izborni kurikulum, koji ispunjavaju kriterijume kvalifikovanja, koji su zaposleni ili imaju ugovor da relevantnim opštinama, izabira ODO i oni će biti uključeni u izradi programa izbornog kurikuluma;<br><br>3.4. ODO izbor nastavnika vrši na osnovu kvalitet dostavljenih programa.<br><br>3.5. Njihovo angažovanje od strane ODO istovremeno se vrši usvajanjem konačne liste izbornog kurikularnih predmeta. |

| | | |
|---|---|---|
| përfundimtare të lëndëve të kurrikulës me zgjedhje.<br><br>3.6. Përzgjedhja e kuadrit mësimdhënës për të punësuarit e rinj, bëhet sipas paragrafit 4 të këtij neni.<br><br>4. Procedura dhe kriteret e përzgjedhjes së kuadrit për realizimin e kurrikulës me zgjedhje, janë të njëjta me procedurën dhe kriteret e përzgjedhjes së kuadrit të rregullt mësimor.<br><br>**Neni 11**<br>**Aprovimi**<br><br>1. Komisioni përgatit dosjen për procesin e organizimit të kurrikulës me zgjedhje. Dosja përmban:<br><br>1.1. Listën e lëndëve të përzgjedhura për secilën klasë;<br><br>1.2. Programet e hartuara dhe planifikimet vjetore për lëndët e përzgjedhura;<br><br>1.3. Raportin për procesin e përzgjedhjes, bashkë me dëshmitë e nevojshme, të cilat përfshijnë: procesverbalet e takimeve të këshillave të klasave me listat e propozuara, | 3.6.The selection of teaching staff for new employees is made according to paragraph 4 of this article.<br><br>4. The procedure and criteria for the selection of the staff for the implementation of the elective curriculum are the same as the procedure and criteria for the selection of the regular teaching staff.<br><br>**Article 11**<br>**Approval**<br><br>1. The commission prepares the file for the process of organizing the elective curriculum. The file contains:<br><br>1.1. List of elective subject for each class;<br><br>1.2. Developed programs and annual plans for selected subjects;<br><br>1.3. The report on the selection process, together with necessary evidence, which includes: the minutes of the meetings of the class councils with the proposed lists, declaration forms, declarations of parents, respectively of students. | 3.6. Odabir nastavnog kadra za ove zaposlene, vrši se shodno stavu 4 ovog člana.<br><br>4. Procedura i kriterijumi izbora kadra za realizaciju izbornog kurikuluma su isti sa procedurama i kriterijumima za izbor redovnog nastavnog kadra.<br><br>**Član 11**<br>**Odobravanje**<br><br>1. Komisija priprema dosije za proces organizovanja izbornog kurikuluma. Dosije sadrži:<br><br>1.1. Spisak izabranih predmeta za svaki razred;<br><br>1.2. Sastavljeni programi i godišnje planiranje za izabrane predmete;<br><br>1.3. Izveštaj o procesu izbora, zajedno sa potrebnim dokazima, koji obuhvataju: zapisnike sa sastanaka razrednih saveta sa predloženim listama, obrasce deklaracije, izjave roditelja, odnosno učenika. |

| | | |
|---|---|---|
| formularët e deklarimit, deklarimet e prindërve, respektivisht nxënësve.<br><br>2. Drejtori i shkollës i prezenton KDSH-së lëndët e përzgjedhura për miratim.<br><br>3. Lista e lëndëve të miratuara nga KDSH, bashkë me programet e hartuara dhe planifikimet vjetore për lëndët e përzgjedhura, dorëzohet në DKA.<br><br>4. Pas verifikimit, DKA aprovon listën përfundimtare të lëndëve zgjedhore në secilën shkollë për realizim në vitin e ardhshëm shkollor:<br><br>4.1. Aprovimin e bën komisioni ad-hoc i DKA-së për kurrikulën me zgjedhje;<br><br>4.2. Komisioni i DKA për kurrikulën me zgjedhje përbëhet nga dy zyrtarë të arsimit, një drejtor shkolle, një mësimdhënës dhe një përfaqësues i Këshillit të Prindërve të Komunës.<br><br>**Neni 12**<br>**Planifikimi, realizimi dhe vlerësimi**<br><br>1. Pas aprovimit, lëndët me zgjedhje marrin statusin e barabartë sikur të gjitha lëndët tjera. | 2. School Principal presents to the SSC the selected subjects for approval.<br><br>3. The list of subjects approved by by SSC, together with the developed programs and annual plans for the selected subjects, is submitted to MED.<br><br>4. After verification, MED approves the final list of elective subjects to each school for realization in the following school year.<br><br>4.1. The approval is done by the ad-hoc commission of the MED for the elective curriculum.<br><br>4.2. The MED commission for the elective curriculum consists of two education officials, a school principal, a teacher and a representative of the Municipality Parents' Council.<br><br>**Article 12**<br>**Planning, realization and evaluation**<br><br>1. Upon approval, elective subjects receive equal status as all other subjects. | 2. Direktor škole predstavlja ŠUO izabrane predmete, za usvajanje..<br><br>3. Spisak predmeta odobrenih od strane ŠUO, zajedno sa sastavljenim programima i godišnjim planiranjem za odabrane predmete, dostavlja se ODO-u.<br><br>4. Nakon verifikacije, ODO usvaja konačnu listu izbornih predmeta u svaku školu za realizaciju u narednoj školskoj godini.<br><br>4.1. Odobrenje vrši ad-hoc komisija ODO-a za izborni nastavni kurikulum.<br><br>4.2. Komisiju ODO za izborni kurikulum vrše dva službenika iz obrazovni sistem, jedna direktor škole, jedna nastavnik i predstavnik Opštinskog saveta roditelja.<br><br>**Član 12**<br>**Planiranje, realizacija i ocenjivanje**<br><br>1. Nakon odobrenja, izborni predmeti dobijaju jednak status kao i svi ostali predmeti. |

| | | |
|---|---|---|
| 2. Lëndët me zgjedhje planifikohen, realizohen dhe vlerësohen si çdo lëndë tjetër në kuadër të kurrikulës bërthamë.<br><br>**Neni 13**<br>**Afatet e organizimit të kurrikulës me zgjedhje** | 2. The elective subjects are planned, implemented and evaluated like any other subject within the core curriculum.<br><br>**Article 13**<br>**Deadlines of organizing elective curricula** | 2. Izborni predmeti se planiraju, realizuju i ocenjuju kao i svaki drugi predmet u okviru osnovnog kurikuluma.<br><br>**Član 13**<br>**Rokovi za organizovanje izbornog kurikuluma** |
| 1. Këshillat e klasave propozojnë lëndët me zgjedhje deri në fund të muajit prill të vitit paraprak shkollor. | 1. The class councils propose elective subjects till the end of April month of the previous school year. | 1. Razredni saveti predlažu izborne predmete do kraja aprila meseca prethodne školske godine. |
| 2. Komisioni përgatit formularët e deklarimit deri në fund të muajit maj të vitit paraprak shkollor. | 2. The commission prepares the declaration forms till the end of Maj month of the previous school year. | 2. Komisija priprema obrasce deklaracije do kraja maja meseca prethodne školske godine. |
| 3. Deklarimi i prindërve, respektivisht nxënësve për lëndët me zgjedhje bëhet në muajin qershor, para përfundimit të vitit paraprak shkollor. Nxënësit të cilët kanë përfunduar klasën e IX, deklarohen me rastin e regjistrimit në shkollat e mesme të larta. | 3. The declaration of parents, respectively students, for elective subjects is made in June, before the end of the previous school year. Students who have completed IX grade, are declared when enrolled in higher secondary schools. | 3. Izjava roditelja, odnosno učenika, za izborne predmete vrši se juna meseca pre završetka prethodne školske godine. Učenici koji su završili . IX se izjašavaju prilikom upisa u više srednje škole. |
| 4. Komisioni përgatit listën e lëndëve të përzgjedhura për çdo klasë, në qershor të vitit paraprak shkollor. | 4. The commission prepares the list of selected subjects, for each grade, in June of the previous school year. | 4. Komisija priprema listu izabranih predmeta, za svaki razred, juna meseca prethodne školske godine. |
| 5. Mësimdhënësit e përzgjedhur për realizimin e lëndëve me zgjedhje, në bashkëpunim me aktivet profesionale, hartojnë programet e lëndëve me zgjedhje | 5. The teachers selected for the realization of elective subjects, in cooperation with professional assets, compile programs of | 5. Nastavnici izabrani za realizaciju izbornih predmeta, u saradnji sa stručnim aktivima, sastavljaju programe izbornih predmeta i |

| | | |
|---|---|---|
| dhe përgatisin planin vjetor, në korrik të vitit paraprak shkollor.<br><br>6. KDSH miraton listën e lëndëve me zgjedhje, programet dhe planet vjetore të lëndëve me zgjedhje, në korrik të vitit paraprak shkollor.<br><br>7. Shkolla dorëzon në DKA listën përfundimtare të lëndëve me zgjedhje për çdo klasë, në korrik të vitit paraprak shkollor.<br><br>8. DKA aprovon listën e miratuar të lëndëve dhe moduleve zgjedhore dhe të personelit mësimdhënës në gusht të vitit paraprak shkollor, së paku një javë para fillimit të viti të ri shkollor.<br><br>9. DKA kthen listën përfundimtare të lëndëve zgjedhore në secilën shkollë në gusht të vitit paraprak shkollor.<br><br>10. Lëndët e njëjta për klasë të njëjta, të përzgjedhura vite më herët, që kanë kaluar të gjitha procedurat e përzgjedhjes sipas përcaktimeve me këtë UA, nëse me deklarime të nxënësve/prindërve marrin miratim dhe shkolla ka kuadrin mësimor adekuat, atëherë: | elective subjects and prepare the annual plan, in July of the previous school year.<br><br>6. SSC approves the list of elective subjects, programs and annual plans of elective subjects, in July of the previous school year.<br><br>7. The school submits to the MED the final list of elective subjects for each grade, in July of the previous school year.<br><br>8. MED approves the approved list of elective subjects and modules and teaching staff in August of the previous school year, at least one week before the start of the new school year.<br><br>9. MED returns the final list of elective subjects to each school in August of previous school year.<br><br>10. The same subjects for the same class, selected years earlier, that have passed all the selection procedures according to the provisions of this AI, if they are approved by declarations of students/parents and the school has an adequate teaching staff, then: | pripremaju godišnji plan, jula meseca prethodne školske godine.<br><br>6. ŠUO odobrava listu izbornih predmeta, programa i godišnje planove izbornih predmeta, jula meseca prethodne školske godine.<br><br>7. Škola dostavlja u ODO konačnu listu izbornih predmeta za svaki razred, jula meseca prethodne školske godine.<br><br>8. ODO odobrava listu usvojenih izbornih predmeta i izbornih modula i nastavnog osoblja avgusta meseca prethodne školske godine, najmanje nedelju dana pre početka nove školske godine.<br><br>9. ODO vraća konačnu listu izbornih predmeta u svakoj školi avgusta meseca prethodne školske godine.<br><br>10. Isti predmeti za isto razred, izabrani ranijih godina, koji su prošli sve procedure izbora u skladu sa odredba ovog AU, ako su izjavama učenika/roditelja i škola dobiju odobrenje i škole imaju adekvatan nastavni kadar, u tom slučaju:<br><br>10.1. Nema potrebe ide kroz nove |

| | | |
|---|---|---|
| 10.1. Nuk ka nevojë të kalojnë në procedura të reja të miratimit nga KDSH dhe DKA;<br><br>10.2. KDSH dhe DKA vetëm informohen nga drejtori i shkollës;<br><br>10.3. Mësimdhënësit e përzgjedhur për realizimin e lëndëve me zgjedhje, në bashkëpunim me aktivet profesionale, përgatisin/rishikojnë vetëm planin vjetor, në korrik të vitit paraprak shkollor.<br><br>**Neni 14**<br>**Zbatimi dhe mbikëqyrja**<br><br>1. Ky Udhëzim administrativ duhet të zbatohet nga MASHTI dhe nga të gjitha institucionet e arsimit dhe aftësimit parauniversitar (nivelet arsimore 1, 2 dhe 3).<br><br>2. Mbikëqyrjen e zbatimit të këtij Udhëzimi administrativ e bën Inspektorati i arsimit. | 10.1. There is no need to go through new approval procedures from SSC and MED.<br><br>10.2. SSC and MED are only informed by the school principal.<br><br>10.3. The teachers selected for the realization of elective subjects, in cooperation with professional assets, compile programs of elective subjects and prepare the annual plan, in July of the previous school year.<br><br>**Article 14**<br>**Implementation and Supervision**<br><br>1. This Administrative Instruction must be implemented by MESTI and by all pre-university education and training institutions (educational levels 1, 2 and 3).<br><br>2. The implementation supervision of this Administrative Instruction is done by the Inspectorate of Education. | procedure na odobrenje od strane ŠUO i ODO.<br><br>10.2. ŠUO i ODO samo dobijaju informacije od direktora škole.<br><br>10.3. Nastavnici izabrani za realizaciju izbornih predmeta, u saradnji sa stručnim aktivima, pripremaju/revidiraju samo godišnji plan, jula meseca prethodne školske godine.<br><br>**Član 14**<br>**Sprovođenje i nadzor**<br><br>1. Ovo administrativno uputstvo mora sprovodi MONTI i sve institucije za preduniverzitetsko obrazovanje i osposbljavanje (nivoi obrazovanje 1, 2 i 3).<br><br>2. Nadzor i sprovođen ovog Administrativnog uputstva vrši Inspektorat za obrazovanje. |

| Neni 15<br>**Shfuqizimi** | Article 15<br>**Repeal** | Član 15<br>**Stavljanje van snage** |
|---|---|---|
| Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi administrativ, shfuqizohet Udhëzimi administrativ nr. 32/2013, Organizimi i kurrikulës me zgjedhje në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. | With entry into force of this Administrative instruction is repealed the Administrative instruction no. 32/2013, Organization of Elective Curricula at all levels of pre-university education. | Stupanjem na snagu ovog Administrativnog uputstva, stavlja se, van snage Administrativno uputstvo br. 32/2013 Organizovanje Izbornog kurikuluma na svim nivoima preduniverzitetskog obrazovanja. |
| **Neni 16**<br>**Hyrja në fuqi** | **Article 16**<br>**Entry into force** | **Član 16**<br>**Stupanje na snagu** |
| Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare. | This Administrative instruction enters into force seven (7) days after the publication in the official gazette. | Ovo Administrativno Uputstvo stupa na snagu sedam (7) dana nakon objavljivanja u Službenom glasniku. |
| **Arbërie Nagavci**<br>____________<br>**Ministre**<br>**Dt.** 02 . 05 . 2023 | **Arbërie Nagavci**<br>____________<br>**Minister**<br>**Date.** ____.____.____ | **Arbërie Nagavci**<br>____________<br>**Ministarka**<br>**Dat.**____.____.____ |